



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2018:007353

Datë: 28.03.2018

Numri i dokumentit: 00018924

P.nr.1019/2017

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE GJILAN DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM DIVIZIONI PENAL Sipas gjyqtarit Ramiz Azizi, me pjesëmarrjen e zyrtarës ligjore Florentina Ademi në lëndën penale kundër të pandehurit Z.D. nga fsh. ... K..., për shkak të veprës penale vjedhje pylli nga neni 358 paragrafi 1 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës Nr.04/L-082 (KPRK), duke vendosur sipas aktakuzës së Prokuroria Themelore Gjilan - Departamenti i përgjithshëm nr. PP.II.1690/2017 , të datës 25.09.2017 në seancën publike të shqyrtimit gjyqësor të mbajtur me datë 27.03.2018 në praninë e Prokurorit të Shtetit Shefik Memeti të pandehurit Z.D., më datë 27.03.2018 mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari Z.D. nga babai S. dhe nëna M. i lindur më: data e lindjes...ne fsh. ... ku edhe jeton, i martuar, baba i një fëmije, ka të kryer shkollën e mesme, i pa punë i gjendjes së varfër ekonomike, sërb, shtetas i Republikës së Kosovës.

**Ështe Fajtor
Sepse**

Më datë 05.09.2017, rreth orës 16.20 minuta, në terrenin e fshatit ... K. ..., në pyllin e pronës shtetërore, në vendin e quajtur “ ... ”, i pandehuri me qëllim vjedhje, me sharrë dore ka prerë 81 copë drurë të njoma të llojit “Bung”, me diametër në cung 10-12 cm, në lartësi prej 6 metra, me vëllim të përgjithshëm prej 2.30 m³ dhe në këtë mënyrë të dëmtuarës APK-së, i ka shkaktuar dëm matërial në shumë përafërsisht 294.40 Euro.

-me çka ka kryer veprë penale: vjedhje pylli nga neni 358 paragrafi 1 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Andaj gjykata në bazë të dispozitave 4,7,17,21,49,50,51,52, e 73 të KPRK-së, si dhe neneve 365 459 e 463 të KPRK-së, të akuzuarit i shqipton:

DËNIM TË KUSHTËZUAR ME BURGIM

Të akuzuarit Z.D. i shqiptohet dënim burgu në kohëzgjatje prej 180 (njëqind e tëtëdhejtë) ditë, të cilin dënim i akuzuari nuk do ta mbajë nëse në afat prej 1 (një) viti nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë, nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale.

Obligohet i akuzuari që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj 20 Euro, si dhe hargjimet e procedurës penale të përlogarituara sipas llogarisë përfundimtare të kësaj gjykate, në afat prej 15 ditëve pasi që ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

E dëmtuara ...-Zyra Regjionale në ... për realizimin e kërkesës pasurore – juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjilan ka ngritur aktakuzën me numër PP.II.1690/17, të datës 25.09.2017, ndaj të akuzuarit Z.D., nga fsh. ... K.... për shkak të vepës penale vjedhje pylli nga neni 358 paragrafi 1 i KPRK-së.

Në shqyrtimin gjyqësor të mbajtur më datë 27.03.2018, prokurori i shtetit Shefik Memeti pos tjerash pohoi se mbetet në tërësi pranë aktakuzës së lartcekur, duke theksuar se në shqyrtimin e sotëm gjyqësor pa mëdyshje është vërtetuar se i akuzuari Z., është përgjegjës për veprën penale që i vihet në barrë, e vërtetuar nga dëgjimi i dëshmitarit A.S., rojtar pylli pranë ...së në ..., si dhe nga provat tjera materiale andaj kërkoj që ai të shpallet përgjegjës për veprën penale dhe të akuzuarit t'i shqiptohet dënimi i paraparë me ligj si dhe gjatë matjes së dënimit ndaj të akuzuarit të merren parasyshtë rrethanat lehtësuesë dhe ato rënduese

I akuzuari Z.D., në fjalën përfundimtare kërkoj që të lirohet nga përgjegjësia penale pasi që nuk e ndien veten përgjegjës për këtë vepër penale, duke pohuar se të njejtën ai nuk e ka kryer.

Pas mbajtjes së shqyrtimit të sotëm gjyqësor, administrimit të provave një nga një e të gjitha së bashku si tërësi konform nenit 361 të KPRK-së, gjykata konstatoi këtë gjendje faktike se :

Është e vërtetë se i akuzuari Z.D. nga fsh. ... K.... ka kryer veprën penale vjedhje pylli nga neni 358 paragrafi 1 i KPRK-së, ashtu siç është përshkruar në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Këtë gjendje faktike gjykata e vërtetoi dhe konstatoi duke u bazuar në këto prova

-dëshmia e dëshmitarit A.S. i cili është roje pylli pranë ...-së zyra në ... në territorin e fsh. .. ku edhe është kryer vepra penale nga i akuzuari,

- fletëparaqitja e ...-së Zyrja në ... e datës 20.09.2017 me numër ..., si dhe nga fotokopja e ditarit të rojtarit të pyllit A.S. nr: ... i datës 05.09.2017, të cilat gjinden në shkresat e kësaj lënde.

- pjesërisht edhe nga mbrojtja e të akuzuarit Z.D. e dhënë në seancën e sotme.

Dëshmitari A.S. i cili është edhe roje pylli pranë ...-së Zyrja në ..., në seancën e sotme më 27.03.2018 pos tjerash deklaroi se ditën kritike rreth orës 16.20 min në pyllin e pronës shtetërore në vendin e quajtur “ ... ” në territorin e fshatit ... K. ..., gjersa isha duke kontrolluar pyllin dëgjova zhurmën e sharrës së dorës, ku i akuzuari mbi rrugë ishte duke prerë dru të njomë të llojit “Bung” me sharrë dore, ku iu afrova vendit kritik, e ftova të akuzuarin duke i thënë “ndal”, e i njëjti pasi që ishte mbi rrugicë e unë isha nën rrugicë, vrapova dhe dola në rrugë dhe i njëjti pasi që me hetoi mua edhe ai doli në rrugë e kisha afër 10-15 metra, pastaj iu afrova në afërsi rreth 4-5 metra, kërkova që të ndalet e i njëjti u ndal, nxora telefonin që ta fotografojë e i njëjti u përkuul duke u lutur që t’ia falë – të mos e shënoj, i kërkova që ta tregoj emrin dhe mbiemrin por i njëjti më dha emra të ndryshëm duke mos e treguar emrin e vërtetë të tij me qëllim që të mos e shënoj në fletëparaqitje. Mezi e fotografova pasi që i njëjti kishte në dorë sharrën dhe një shishe të plastikës të lidhur me tojë, pastaj shkova në fshat poshtë në ... dhe pyeta një person se a e njeh të njëjtin dhe ai e identifikoi se i njëjti është Z.D. dhe ia shkrova veprën si në dispozitivin e kësaj aktakuze. Kjo që po e them është e vërtetë dhe jam në gjendje të bëjë ballafaqim me të njëjtin. Këtë që po e them e kam shkruar edhe në fletëparaqitje dhe nuk tërhiqem nga ajo që kam thënë në këtë dëshmi timen.

Edhe nga fletëparaqitja me nr: ... si dhe ditari i rojtarit të pyllit A.S. me nr: ... e datës 05.09.2017 të cilat janë në shkresat e kësaj lënde dhe me të cilat vërtetohet dëshmia e dëshmitarit A.S.

I akuzuari Z.D., në mbrojtjen e tij të dhënë në gjykatë, mes tjerash pohon se ditën kritike kur është shkruar në fletëparaqitje, është takuar me rojtarin e pyllit – dëshmitarin A.S., e që ishte duke u shëtitur nëpër pyll me sharrë dore në supin e dorës së djathtë e i njëjti kishte edhe një shishe të plastikës me ujë, por mohon se ishte duke prerë dru, dhe pohon se ishte përkulur që të mos e fotografojë sepse ai ishte i frikësuar se mos po e vret ngase roja e pyllit ia kishte drejtuar pushkën në drejtim të tij dhe të njëjtën e kishte raportitur, dhe as që kishta prerë fare dru – deklaroi i akuzuari.

Gjyqari i vetëm gjykues, me kujdesë shqyrtoi dhe analizoi provat e shtjelluara si: dëshminë e dëshmitarit A.S., provat materiale si: fletëparaqitjen me nr: ... dhe ditarin e rojtarit të pyllit me nr: ... i datës 05.09.2017, të cilave prova gjykata ia falë besimin nga shkak se nga këto prova vërtetohet në mënyrë bindëse gjendja faktike se i akuzuari Z.D. ka kryer veprën penale vjedhje pylli nga nen i 358 paragrafi 1 i KPRK-së, si në vendin kohën dhe mënyrën e treguar në dispozitiv të këtij aktgjykimi, gjë që edhe nga vetë mbrojtja e të akuzuarit ai pohon se kishte qëlluar në vendngjarje ditën kritike dhe se me vete kishte sharrën e dorës, por mohon që të ketë prerë dru dhe se kishte dalur vetëm për shëtitje, gjë që gjykata nuk ia fal besimin mbrojtjes së të akuzuarit.

Andaj duke u bazuar në këto që u cekën më lart gjykata të akuzuarin Z.D. nga fsh. ... K...., e shpalli fajtor për kryerjen e veprës penale vjedhje pylli nga neni 358 paragrafi 1 i KPRK-së, siç është përshkruar në dispozitiv të këtij aktgjykimi ngase veprimet e të njëjtit përmbajnë të gjitha tiparet e veprës penale dhe për të cilën vepër është penalisht përgjegjës.

Me rastin e matjes së dënimit ndaj të akuzuarit Z.D., gjykata konform neni 73 ka marrë parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe ato rënduese, ku si rrethana lehtësuese mori gjendjen e vështirë ekonomike, sjellejn e mire gjatë shqyrtimit gjyqësor, është mbajtës i familjes, se është baba i një fëmije të vetëm, është hera e parë që ndeshet me ligjin, kurse si rrethanë rënduese dëmin e shkaktuar të dëmtuarës ...-së zyrja në ...

Sipas bindjes së lirë të kësaj gjykata dënimi i shqiptuar me burgim të kushtëzuar ndaj të akuzuarit Z.D., është marrë duke u bazuar në rrethanat e cekura më lartë, është dënim i drejtë në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit si dhe me këtë lloj dënimi do të mund të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 50 i KPRK-së.

Vendimi mbi paushallin gjyqësor dhe hargjimet e procedurës penale është marrë sipas nenit 451 të KPRK-së.

Vendimi mbi kërkesën pasurore – juridike është marrë bazuar në nenin 463 të KPRK-së.

Nga të cekurat me lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi

**GJYKATA THEMELORE GJILAN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM , DIVIZIONI PENAL**

2018:007353, 27.03.2018

G j y q t a r i

Ramiz Azizi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga koha e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.

Numri i lëndës: 2018:007353
Datë: 28.03.2018
Numri i dokumentit: 00018924